

MENDIM PARALEL

Unë, Lulzim Hamitaj, në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues që ka kryer procesin e rivlerësimit kalimtar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Shpëtim Reka, - duke mbështetur vendimmarrjen përfundimtare me aplikimin e nenit 61, pika 5, - por duke mos qenë dakord me konkluzionin e përshkruar në pikën 60.10, (në faqen 52), të vendimit në fjalë, po specifikoj qëndrimin tim lidhur me sa vijon.

Ndonëse është provuar dhe pranuar fakti i përdorimit, nga ana e subjektit të rivlerësimit, të një automjeti në pronësi të shtetasit Xh. T., person ky me precedentë penalë, vlerësoj se nuk mund të konsiderohet gjithashtu si i provuar fakti se subjekti i rivlerësimit kishte dijeni, në momentin e përdorimit të këtij automjeti dhe/ose në momentin e plotësimit të deklarimit për kontrollin e figurës prej tij, mbi kualifikimin e pronarit të mjetit si person i përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore përkatëse. Kjo pasi, subjekti ka mohuar jo vetëm të këtë dijeni, por edhe ekzistencën e kontaktit direkt apo të marrëdhënies/njohjes me këtë person dhe Komisioni nuk ka materializuar provën e kundërt, përpos dyshimeve që mund të ngrihen mbi bindshmërinë ose jo të shpjegimeve të paraqitura nga subjekti.

Nisur nga sa më sipër, në këndvështrimin tim, duke pasur në vëmendje dinamikën e ngjarjeve dhe shpjegimet e subjektit, të përshkruara në vendim, sipas meje mund konkludohet se:

- a- Subjekti i rivlerësimit ka pasur një marrëdhënie interesi, qoftë edhe indirekte, me shtetasin Xh. T., dhe ky fakt duhet të vlerësohet, së bashku me gjetjet e tjera, nën dritën e aplikimit të nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, për cenim të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë;
- b- Por, në mungesë të provës së qartë mbi dijeninë e subjektit të rivlerësimit mbi ekzistencën dhe tipologjinë e precedentëve penalë të shtetasit Xh. T., nuk mund të konkludohet për fshehje të qëllimshme të fakteve dhe për plotësim të pavërtetë të formularit/deklarimit për kontrollin e figurës nga ana e subjektit.

Në fund, çmoj të theksoj se, në rast se do të merrej e mirëqenë ose do të ishte provuar fshehja e qëllimshme e fakteve si më sipër nga subjekti dhe plotësim të pavërtetë të formularit/deklarimit për kontrollin e figurës, nisur nga parashikimet e nenit 38/4 e ligjit nr. 84/2016, në këtë rast do të duhej të ishte aplikuar taksativisht prezumimi i shkarkimit të tij, në zbatim të nenit “DH” të Aneksit të Kushtetutës, pasi do të gjendeshim përballë një shkeljeje flagrante, dhe jo vetëm në rrafshin e një rrethane të dyshimtë mbi një marrëdhënie jo të shëndetshme.

Në vlerësimin tim, vetëm kjo e fundit mund të përthithet në cenimin e besimit të publikut dhe të kontribuojë në aplikimin e nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, ndërsa rrethana e plotësimit të pavërtetë të formularit/deklarimit për kontrollin e figurës, bën detyrimisht të aplikueshëm nenin “DH” të Aneksit të Kushtetutës, i cili duke qenë pikërisht në rang kushtetues, nuk mund të anashkalohej, në favor të aplikimit të një dispozite të rangut inferior (ligjor).

ANËTARI I TRUPIT GJYKUES

Lulzim HAMITAJ / me mendim paralel

